



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:125346  
Datë: 30.04.2024  
Numri i dokumentit: 05638640  
KPPP.nr.450/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Inspektorati Farmaceutik, me seli në Prishtinë, rruga “Instituti B”, kati përdhësë, rrethi i QKUK-së, kundër debitorit “Triomed”, me NRB:810092099, me seli në Prishtinë, Magjistratja Prishtinë - Ferizaj, përfaqësuar sipas autorizimit nga Fisnik Sogojeva, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.084/23 të datës 28.03.2023, të Përmbartuesit Privat Kushtrim Metaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 30.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Triomed”, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.084/23 të datës 28.03.2023, të Përmbartuesit Privat Kushtrim Metaj.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr.084/23 i datës 28.03.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Kushtrim Metaj.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.084/23 të datës 28.03.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartimor - Vendimit të Inspektoratit Farmaceutik Nr.10/AB-003-21 të datës 10.03.2021, me të cilin ka urdhëruar debitorin që menjëherë pas pranimit të këtij urdhri t’i paguaj kreditorit shumën prej 1,000.00 €, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore sipas Tarifës së Përmbartuesve Privat nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm, në të kundërtën përmbartimi

të realizohet me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në të gjitha llogaritë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë e përmbaruesit, regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe nga shitja e tyre të realizohet borxhi ndaj kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarimor, duke theksuar se kreditori në momentin e inicimit të procedurës përmbarimore sipas propozimit për përmbarim nuk ka përbushur kushtet në mënyrë që dokumenti përmbarues të jetë i përshtatshëm për përmbarim dhe i njëjti të lejohet me urdhrin përmbarimor. Tutje ka shtuar se aktvendimi i cili është objekt i kësaj procedure përmbarimore nuk i është dorëzuar asnjëherë debitorit, andaj si i tillë nuk mund të jetë i ekzekutueshëm, për më tepër ka deklaruar se vendimi i cili është objekt i kësaj procedure përmbarimore është nxjerr në kundërshtim me ligjin për produkte dhe pajisje medicinale, pasi që i njëjti i shqiptohet subjekteve juridike e jo pronarit të subjektit. Gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj prapësimin e debitorit, urdhrin përmbarimor ta shfuqizoj si dhe ta detyroj kreditorin që debitorit t'ia kompensoj shpenzimet e paraqitjes së prapësimin shumën prej 156.00 €.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke i'u referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarimor, përkatësisht – Vendimin e Inspektoratit Farmaceutik Nr.10/AB-003-21 të datës 10.03.2021, në bazë të së cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin dhe gjeti se i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së,

është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata gjeti se Vendimi i Inspektoratit Farmaceutik Nr.10/AB-003-21 i datës 10.03.2021, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shumën dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që i njëjti përmban të dhënat për kreditorin dhe debitorin, shumën të cilën e ka obligim ta paguaj debitori dhe kohën e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Vendimi i Inspektoratit Farmaceutik Nr.10/AB-002-21 i datës 25.01.2021, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmëris për përmbarueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbarueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*, ngase Vendimi Nr.10/AB-002-21 i datës 25.01.2021, i nxjerrë nga Inspektorati Farmaceutik, është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm nga data 10.11.2022.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.450/24, datë 30.04.2024

Gjyqtarja  
Verona Dibra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.